




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>20/DPK</u>	Nr Prot. Br Prot. <u>01-325/15</u>
Nr. i faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>09-02-2015</u>
Nr. pages	Date
PRISTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.02.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-5070-15 për *z.Nëntor Fetiu – Ish Anëtar i Këshillit drejtues të Teatrit Kombëtar të Kosovës, për shkak se ai tashmë nuk e ushtron këtë funksion publik.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti është hapur pas kërkesës së nëpunësit civil për sqarim lidhur me mundësinë e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-5070-15, për palën e interesuar z. Nëntor Fetiu – tashmë ish Anëtar i Bordit të Teatrit Kombëtar të Kosovës.

Z. Fetiu ka qenë i interesuar të dijë me shumë për situatat e konfliktit të interesit duke marr një shembull konkret për një situatë e cila në fakt nuk ka ndodhur, por z.Fetiu ka pyetur a do të ishte konflikti i interesit sikur gruaja e tij të konkurronte për Anëtare të trupës së Teatrit Kombëtar, në kohën kur ai ka qenë Anëtar i Këshillit drejtues të Teatrit Kombëtar, edhe pse përzgjedhjen e tyre e bënë një komision i veçantë.

Ne i kemi dhënë sqarimet me gojë z.Fetiu ditën kur ka qenë në Agjenci, por meqenëse pastaj e ka bërë kërkesën me shkrim, dhe ndërkohë ai dhe të gjithë Anëtarët tjerë të Këshillit drejtues të Teatrit Kombëtar me një Vendim të Ministrit të MKRS-së janë shkarkuar nga këto funksione, z.Fetiu na ka njoftuar dhe ka deklaruar se heq dorë nga kërkesa për sqarim lidhur me këtë situatë, meqë tashmë nuk e ushtron këtë funksion.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /



[Handwritten signature]